

## AUTORIZIM PER PAGESA AUTOMATIKE

### 1. TË DHËNAT E OFRUESIT TË SHËRBIMIT

ProCredit Bank sh.a person juridik i regjistruar në Qendrën Kombetare të Biznesit me nr. Unik identifikimi (NUIS) J91524011J, në datë 11.02.1999, me seli Rruga Dritan Hoxha, Laprakë, Tiranë.

#### TË DHËNAT MBI KOMPANINË /COMPANY INFORMATION

Emri i Kompanisë  
NUIS  
Përfaqësues Ligjor  
Adresë

---

---

---

---

**Autorizoj Procredit Bank sh.a**  
të debitojë llogarinë time me numër

---

për pagesën mujore të faturës së lëshuar nga:

- Albtelekom Sh.a
- Telekom Sh.a
- FSHU (Furnizuesi I Shërbimit Universal)
- "Ujësjetës" Sh.a.
- Vodafone Albania

Me të dhënat si më poshtë duke filluar nga pagesa e faturës së muajit në të cilin nënshkruhet autorizimi. Kjo pagese do te behet muajin pasardhes.

**Emër Mbiemër i Abonentit**

---

**Kodi i kontratës:**

---

**Nr. Telefoni fiks/celular:**

---

Me qëllim kryerjen e pagesës të sipërpërmendur, autorizoj kompaninë e përzgjedhur më sipër dhe ProCredit Bank për kalimin tek njëra-tjetra të të dhënave të mia personale (emër, mbiemër, adresë, numër kontrate, vlera e shpenzimit mujor të energjisë elektrike/ujit/numër celular, numër llogarie bankare).

Debitimi i llogarisë do të bëhet brenda datës 10 të muajit, nëse në llogarinë time ka gjendje të mjaftueshme për shlyerjen e plotë të faturës. Në rast se gjendja e llogarisë nuk është e mjaftueshme për shlyerjen e plotë të faturës në datën e mësipërme, unë autorizoj Bankën të kryejë pagesën e faturës në momentin kur gjendja e llogarisë time të jetë e mjaftueshme, deri në ditën e fundit të muajit (data 30 /31. Per muajin Shkurt 28/29 ).

Une deklaroj se cdo pretendim që mund të kem për faturën/faturat e telefonisë celulare, do të zgjidhet ndërmjet meje dhe kompanisë/ve si më lartë

Unë deklaroj se njoh dhe pranoj kushtet e punës të ofruara nga Banka për këtë shërbim, të printuara në faqen e dytë të ketij autorizimi.

Ky autorizim është pa afat dhe konsiderohet i është i vlefshëm deri në një revokimin timin në formë të shkruar

Vendi ,Data  
(Place,Date)

Emër,Mbiemër, Nënshkrimi ,Vula e mbajtësit të llogarisë  
(Name,Surname,Signature,Stamp of Account Holder)

## KUSHTET E PUNËS

1. Banka merr persiper debitimin e llogarisë së klientit për pagesën e faturave për kompaninë/kompaninë, e përzgjedhura më sipër sipas autorizimit të dhënë nga ky i fundit brenda datës 10 të muajit. Në rast se në këtë datë nuk ka gjendje të mjaftueshme për likuidimin e plotë të faturës/ave, Banka do të kryejë debitimin e faturës/faturave në momentin e parë që do të ketë gjendje të mjaftueshme në llogarinë e tij deri ditën e fundit të muajit.
2. Në rast se data 10 e muajit është dite pushimi, banka do të kryejë pagesën e faturave të klientëve në ditën pasardhëse të punës.
3. Pas datës 30 / 31 (ditës së fundit të muajit), Banka nuk merr përsipër të kryejë pagesat e faturës/ave të papaguara brenda muajit. Për muajin shkurt kjo date është 28 ose 29. Këto fatura duhet të paguhën nga vetë klienti në sportelet e arkës ose nëpërmjet llogarisë në bankë ose me internet banking nëse e disponon këtë shërbim.
4. Banka pranon edhe pagesën e faturave të prapambetura për veprimet që kryhen në arkë ose nëpërmjet llogarisë së klientit.
5. Në rastin kur klienti nuk ka gjendje të mjaftueshme në llogari për likuidimin e plotë të faturës/ave dhe ka Overdraft të aprovuar, atëherë do të përdoret edhe Overdrafti për likuidimin e faturës/ave.
6. Në rast se edhe gjendja e Overdraftit nuk është e mjaftueshme për likuidimin e plotë të faturës/ave, kjo pagesë nuk do të kryhet.
7. Banka nuk do të kryejë pagesën e faturës/ave, në rast se klienti nuk ka gjendje të mjaftueshme për likuidimin total të faturës. Pagesa e faturës do të ekzekutohet nga banka pavarësisht nga vlera e saj, nëse gjendja e llogarisë së klientit është e mjaftueshme për të bërë likuidimin e plotë të faturës.
8. Pagesa e faturës/ave me urdhër debitimi automatik aktivizohet muajin pasardhës nga lidhja e marrëveshjes midis klientit dhe bankës, për pagesën e faturës së muajit në të cilin është lidhur marrëveshja.
9. Për të verifikuar pagesën e faturës ndaj kompanisë UJËSJELLËS/ALBTELEKOM/TELEKOM ALBANIA/VODAFONE ALBANIA/FSHU, klienti duhet të kontrollojë nxjerrjen e llogarisë personale. Nxjerrja e llogarisë përbën provë të plotë për klientin që ai ka paguar faturën përkatëse.
10. Për kompaninë UJËSJELLËS/ALBTELEKOM/TELEKOM ALBANIA/VODAFONE ALBANIA/FSHU është e mjaftueshme debitimi automatik i llogarisë së klientit si provë e plote e shlyerjes së detyrimit nëpërmjet pagesave automatike.
11. Banka do të njoftojë klientin për çdo ndryshim që mund të ndodhë në kushtet e punës që aplikon dhe për tarifën që banka aplikon për shërbimin e pagesave të faturave drejt kompanisë UJËSJELLËS/ ALBTELEKOM/TELEKOM ALBANIA/ VODAFONE ALBANIA/ FSHU.

## DEKLARATA E KLIENIT

1. Nëpërmjet këtij formulari Aplikoj(më) për të autorizuar debitimin automatik të llogarisë për të paguar faturat mujore të kompanisë së përzgjedhur me siper. Autorizoj(më) ProCredit Bank sh.a që të kryejë veprimet përkatëse në sistemin e saj për permbushjen e këtij qëllimi.
2. Deklaroj që nënshkrimi i depozituar (emer, mbiemër, firmë) është autentike dhe më përfaqëson në veprimet me Bankën ProCredit .
3. Konfirmoj që kam lexuar dhe marrë parasysh dokumentet në vijim dhe se jam dakord. Kam shkarkuar këto dokumente dhe i kam ruajtur dhe / ose shtypur ato në mënyrë që të jenë në dispozicion për mua përgjithmonë: [Termet dhe kushtet](#) dhe [listën e çmimeve](#) si dhe pasqyrën e shërbimeve të ProCredit Bank
4. Autorizoj bankën ProCredit Bank sh.a që të kryejë ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të regjistruara nëpërmjet këtij formulari. Konfirmoj se informacioni i regjistruar është i vërtetë, korrekt dhe i plotë. Jap pëlqimin tim që Banka të përpunojë të dhënat personale, si dhe informacionin financiar mbi mua përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me Bankën, në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012 "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar". Gjithashtu, deklaroj se jam në dijeni që të dhënat e regjistruara në këtë formular për arsye eficiente dhe cilësie të lartë shërbimi mund të transferohen dhe disa shërbime mund të kryhen në kohë reale nga Banka ProCredit në Kosovë dhe nga kompania QUIPU GmbH në Gjermani (i cili është vend me nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje për të dhënat personale). Për realizimin e shërbimeve të ofruara nga banka kundrejt Klientit nevojitet që të dhënat e tij personale të transferohen në kuptim të ligjit në fuqi "Për mbrojtjen e të dhënave personale" pranë Bankës ProCredit në Kosovë, shtet i cili nuk ka nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye transferimi do të kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar si dhe Udhëzimin Nr. 41, Datë 13. 06. 2014 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave", duke synuar sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.
- Përsa më sipër, jap pëlqimin tim dhe shpreh vullnetin tim të plotë dhe të lirë për kontrollin, përpunimin dhe transferimin e të dhënave të mia personale që janë dhënë në këtë formular drejt këtyre shteteve, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies kontraktore midis meje dhe ProCredit Bank sh.a. Të dhënat personale apo financiare të Klientit, të mbledhura nga Banka, do të kontrollohen, përpunohen, transferohen për qëllim të zbatimit dhe mbarëvajtjes së të gjithë marrëdhënies kontraktore midis Klientit dhe Bankës dhe do të ruhen në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe Udhëzimin Nr. 20, datë 03.08.2012 "Mbi përpunimin e të dhënave personale në sektorin bankar". Autorizoj ProCredit Bank sh.a që të dhenat e përfshira në këtë formular, të kalohen tek kompania e përzgjedhur me siper me qëllim realizimin e shërbimit të pagesës automatike të faturave përkatëse mujore.
- Pranoj që të informohem me me SMS/Tel/ e-mail rreth shërbimeve bankare dhe ProCredit Bank sh.a. Unë mund ta ndërpres komunikimin me SMS/Tel/e-mail në çdo kohë, përmes ueb faqes. Gjithashtu autorizoj ProCredit Bank që të ruaj dhe përpunojë të dhënat e mia personale në përputhje me legjislacionin e fushës përgjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies me Bankën për shërbimet bankare dhe për qëllime promovionale.